



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2018:028273

Datë: 08.04.2019

Numri i dokumentit: 00272069

**P.nr.462/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nacis Sarani, procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.B, nga ....., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë themelore në Prizren PP.nr.61/2015 të datës 12.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Shpend Binaj, të akuzuarit dhe të dëmtuarës V. N, me datën 21.02.2019 publikisht morri dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**G.B**, nga i ati S. dhe nëna S. e lindur H., i lindur me datë .... në ....., ku edhe tani jeton, rruga “...” – “...”, nr....., banesa përball ..., tek udhë kryqi për në fshatin ..., ka të kryer shkollën fillore, kamerier, i pa martuar, baba i ... fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me datën 16.12.2014, rreth orës 15,20 minuta, në ....., saktësisht në rrugën “...”, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës V. N, të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohshëm ose dobësim të një organi në pjesë e trupit të personit tjetër, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri, nën ndikimin e alkoolit e kishte sulmuar fizikisht për shkak të mosmarrëveshje bashkëshortore që kishin mes vete, pasi që i pandehuri G.B, ishte kthyer në shtëpi dhe duke konsumuar alkool dhe cigare të llojit “...”, e kishte goditur me grushta të dëmtuarën e cila duke dashur ti ikë sulmit, ka shkuar në sallonin e shtëpisë dhe në prezencën e nënës së sajë e kishte sulmuar fizikisht të dëmtuarën, viktimën e ndjeshme V. N, të cilës i

shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkruara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjore dr. F. B, të datës 16.02.2015,

Këso dore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KP-ës.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 par.1 pika 1.1., 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 188 par.2 të KP-ës, të akuzuarit i shqipton:

### **DËNIM ME KUSHT**

Vërteton dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe atë në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20,00 Euro, dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 Euro, i akuzuari obligohet që në emër të mbrojtës së viktimave të paguaj shumë prej 30,00 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 61/15 të datës 12.03.2015, kundër të akuzuarit G.B, nga ..., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Shpend Binaj, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj në tërësi pranë aktakuzës PP/II.nr. 61/15 të datës 12.03.2015, kundër të akuzuarit G.B, nga ....., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KP-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu i akuzuari në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr parasysh pranimi i fajësisë nga i akuzuari në mënyrë vullnetare për veprën penale e cila i vihet në barë,

E dëmtuara V. N, nga babai R. dhe nëna N. e lindur I., e lindur me datë ....., në ..., ku edhe jeton, rruga "...", nr....., ka të kryer shkollën e mesme, momentalisht e pa punë, e pa martuar, nënë e .... fëmijëve, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: që si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike.

I akuzuari G.B, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, ngjarja ka ndodhur në kohën, vendin dhe mënyrën siç është përshkruar edhe në dispozitiv të aktakuzës, unë me të dëmtuarën kemi pasur një jetë të përbashkët jashtë martesore 8 vite, nga kjo bashkësi jashtë martesore jemi edhe prindër edhe tre fëmijëve, por për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme e kemi shkëputur këtë bashkësi jashtë martesore, e dëmtuara jeton tek prindërit e saj, ndërsa unë me të njëjtën që një vit nuk kam kurrfarë

kontakti, edhe fëmijët tanë të përbashkët nga bashkësia jashtë martesore, janë nën kujdes të këtu të dëmtuarës, andaj i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lart, dhe rrethanat e mija personale që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, që jam baba i tre fëmijëve, si dhe të vetmin burim të ekzistencës sime e kam punën që punoj si kamerier, andaj të gjitha të cekurat më lart i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 16.12.2014, rreth orës 15,20 minuta, në ....., saktësisht në rrugën “....”, i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës V. N, të cilat lëndime rezultojnë me dëmtime të përkohshëm ose dobësim të një organi në pjesë e trupit të personit tjetër, në atë mënyrë që ditën kritike i pandehuri, nën ndikimin e alkoolit e kishte sulmuar fizikisht për shkak të mosmarrëveshje bashkëshortore që kishin mes vete, pasi që i pandehuri G.B, ishte kthyer në shtëpi dhe duke konsumuar alkool dhe cigare të llojit “marihuanë”, e kishte goditur me grushta të dëmtuarën e cila duke dashur ti ikë sulmit, ka shkuar në sallonin e shtëpisë dhe në prezencën e nënës së sajë e kishte sulmuar fizikisht të dëmtuarën, viktimën e ndjeshme V. N, të cilës i shkakton lëndime të lehta trupore, lëndime këto të përshkuara më për së afërmi në mendimin e ekspertit mjeko ligjore dr. F. B, të datës 16.02.2015,

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 lidhur me par.1 nën par.1.1 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin me kusht paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte e tij pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë i tij, gjer më tani i pa gjykuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, në kuptim të dispozitave të nenit 74 gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, moshën e të akuzuarit, bashkëpunimin e përgjithshëm të akuzuarit me gjykatën, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, personalitetin dhe rrethanat familjare të akuzuarit, shprehja e keqardhjes të akuzuarit për veprën penale të shkaktuar, kërkim faljen publike para gjykatës të akuzuarit ndaj të dëmtuarit, si dhe sjelljen korrekte të tij gjatë shqyrtimit si dhe pas veprës penale të shkaktuar, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe atë dënimin me burgim në kohë zgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë të tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.462/2015 me datë 21.02.2019**

**Procesmbajtësja**  
**Nacis Sarani**

**Gjyqtari,**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.